

UDHËZUES NË LIDHJE ME KËRKESËN TUAJ

Formulari i kërkesës

Qëllimi i formularit me titull *Kërkesë për Pranim si Viktimë Pjesëmarrëse në Proces Gjyqësor* është që t'ju ndihmojë t'u jepni Dhomave të Specializuara të Kosovës (DHSK) informacionin e duhur për të mundësuar marrjen e një vendimi lidhur me pjesëmarrjen tuaj. Plotësimi i këtij formulari nuk nënkupton automatikisht se kërkesa juaj për pjesëmarrje në proces do të pranohet.

Plotësimi i formularit të kërkesës

Këtë formular mund ta plotësoni nëse besoni se keni pësuar dëm fizik, mendor ose material si pasojë e drejtpërdrejtë e një krimi të pretenduar në një aktakuzë të konfirmuar prej një gjykatësi të procedurës paraprake në DHSK dhe dëshironi të jeni viktimë pjesëmarrëse në çështjen gjyqësore para DHSK-së që trajton atë krim.

Mund të bëni kërkesë edhe nëse keni pësuar dëm si viktimë jo e drejtpërdrejtë. Në këtë rast, duhet të tregoni lidhjen që keni me viktimën e drejtpërdrejtë dhe të paraqisni prova për këtë lidhje.

Ju lutem kini parasysh se, në qoftë se dëmi që keni pësuar është pasojë e një krimi që NUK është pjesë e një aktakuze të konfirmuar prej gjykatësit të procedurës paraprake në DHSK, kërkesa juaj do të refuzohet.

Nëse jeni nën moshën 18 vjeç ose një i rritur të cilin juridiksioni kompetent e ka shpallur juridikisht të paaftë, formularin mund ta plotësojë në emrin tuaj prindi ose kujdestari juaj ligjor të cilët duhet të japin të dhënat e tyre personale dhe të kontaktit në Pjesën 4 të formularit. Në qoftë se edhe ky person e konsideron veten viktimë të një krimi të pretenduar në një aktakuzë të konfirmuar, ai/ajo duhet të plotësojë një formular kërkesë më vete.

INFORMACION I RËNDËSISHËM:

Formulari i kërkesës do t'i jepet gjykatësit të procedurës paraprake ose trupit gjykues dhe bëhet pjesë e dokumentacionit të procesit gjyqësor. Megjithatë, kjo nuk do të thotë që emri, mbiemri, dhe të dhëna të tjera identifikuese tuajat nuk mund t'i jepen publikut, mbrojtësve dhe të akuzuarve dhe Zyrës së Prokurorit të Specializuar (Prokurorisë).

Nëse keni shqetësim për sigurinë tuaj, të familjes suaj dhe të të njohurve tuaj të afërt dhe nuk dëshironi që i gjithë informacioni ose një pjesë e informacionit përmes të cilit mund të identifikoheni t'i bëhet i ditur publikut, mbrojtësit, të akuzuarit dhe/ose prokurorisë, ju lutemi vini shenjë në kutitë përkatëse në Pjesën 3 dhe jepni arsyet për këtë në kutinë e informacionit.

Plotësimi i Pjesës 3 nuk nënkupton automatikisht se kërkesa juaj për mosnxjerrjen e informacionit identifikues do të pranohet. Ju lutemi mbani parasysh se për këtë kërkesë do të marrë vendim gjykatësi i procedurës paraprake ose trupi gjykues. Nëse kërkesa refuzohet, do të informoheni për këtë dhe DHSK-ja do t'ju pyesë nëse dëshironi të vazhdoni me kërkesën tuaj për të marrë pjesë në proces gjyqësor.

Marrja e kërkesës suaj

DHSK-ja do t'ju njoftojë për të konfirmuar marrjen e formularit të kërkesës. Gjithashtu do t'ju dërgohet edhe numri i regjistrimit të cilin duhet ta përdorni kur të komunikoni me DHSK-në.

Nëse do të jetë e nevojshme, Zyra e Pjesëmarrjes së Viktimave do t'ju kontaktojë për informacione shtesë. Në qoftë se dërgoni informacion shtesë, ju lutemi shënoni edhe numrin e regjistrimit të përmendur më lart në mënyrë që të bëhet përditësim i saktë i kërkesës suaj.

Dorëzimi i kërkesës suaj gjykatësit të procedurës paraprake ose trupit gjykues

Zyra e Pjesëmarrjes së Viktimave ia përcjell kërkesën tuaj gjykatësit të procedurës paraprake ose trupit gjykues të caktuar për çështjen që trajton krimin ose krimet e pretenduara që keni shënuar në formular.

Gjykatësi i procedurës paraprake ose trupi gjykues do të vendosë nëse mund të merrni pjesë në proces. Ju do të njoftoheni për vendimin e gjykatësit. Nëse gjykatësi vendos të mos e lejojë pjesëmarrjen tuaj, keni të drejtë ta apiloni vendimin brenda katërmëdhjetë ditësh.

Përfaqësimi juridik

Gjykatësi i procedurës paraprake mund të vendosë t'i ndajë viktimat pjesëmarrëse në grupe, për t'u përfaqësuar bashkërisht. Administratorja do t'i caktojë grupit një avokat nga Lista e Mbrojtësve.

Në caktimin e mbrojtësit për grupin e viktimave, Administratorja merr parasysh, për aq sa është e mundur, pikëpamjet, interesat dhe parapëlqimet e viktimave pjesëmarrëse. Zyra e Pjesëmarrjes së Viktimave mund t'ju kontaktojë lidhur me këtë. Megjithatë, ju lutemi mbani parasysh se nuk do të jetë e mundur të plotësohen të gjitha parapëlqimet, sepse i gjithë grupi i viktimave do të përfaqësohet vetëm nga një avokat.

Pjesëmarrja në procedura

Avokati që do të përfaqësojë grupin tuaj, do t'ju mbajë të informuar gjatë gjithë kohëzgjatjes së procesit, si dhe do të kërkojë mendimet e do të dëgjojë shqetësimet tuaja në lidhje me procesin, me qëllim që t'ua sjellë ato në vëmendje gjykatësve.

Gjatë përfaqësimit të grupit tuaj, avokati mund:

- të jetë i pranishëm në seanca gjyqësore, të bëjë parashtrime me gojë dhe me shkrim dhe të marrë në pyetje dëshmitarë sa herë që trupi gjykues mendon se këtë e kërkojnë interesat dhe të drejtat vetjake të viktimave;
- të ketë qasje në materiale që nevojiten për përfaqësimin e grupit të viktimave, sipas vendimit të trupit gjykues;
- të bëjë deklaratat hyrëse dhe mbyllëse në gjykim;
- t'i kërkojë trupit gjykues të urdhërojë dorëzimin e provave dhe të dëgjojë dëshmitarë në lidhje me ndikimin e krimeve mbi viktimat pjesëmarrëse në proces, nëse këto aspekte nuk u trajtuan në mënyrë të mjaftueshme gjatë çështjes gjyqësore.

Shënim për privatësinë

DHSK-ja është DHSK-ja është e përkushtuar të përmbushë standardet më të larta në mbledhjen dhe përdorimin e të dhënave personale. Shënimi për privatësinë që i bashkëngjitet këtij udhëzuesi ju tregon se çfarë mund të prisni kur DHSK-ja shqyrton kërkesën tuaj. Për informacion të mëtejshëm për mbrojtjen e të dhënave personale në Dhomat e Specializuara të Kosovës, shih <https://www.scp-ks.org/sq/njoftim-privatesine>